

BE LAJME



BE QENDRA
prill 2025
BEQ - nr. 101/2025

UDHËRËFYES PËR FORCIMIN E TË DREJTAVE TË FEMRAVE



Komisioni Evropian, më 7 mars 2025, prezantoi Udhërrëfyes të ri për forcimin e të drejtave të femrave, me qëllim ofrimin e udhëzimeve dhe masave konkrete për avancimin e barazisë gjinore.

Udhërrëfyesi për të drejtat e femrave paraqet dokument udhëzues që udhëzon politikën e ardhshme për barazi gjinore dhe përcakton prioritetet për periudhën e ardhshme. Dokumenti synon të krijojë bazë të fortë për avancimin e mëtejshëm të të drejtave të femrave në të gjithë Bashkimin dhe më gjerë dhe paraqet strategji afatgjatë për promovimin dhe avancimin e të drejtave të femrave në Evropë.

Barazia midis femrave dhe meshkujve është thelbësore për suksesin e BE-së. Gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë së saj dhe përfshirja e tyre e plotë në fuqinë punëtore dhe proceset e miratimit të vendimeve është thelbësore për rritjen ekonomike dhe stabilitetin.

Qëllimi kryesor i Udhërrëfyesit është të arrijë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të femrave në të gjitha sferat e jetës, me fokus të veçantë në sferën politike dhe ekonomike.

Udhërrëfyesi për të drejtat e femrave synon të avancojë parimet dhe qëllimet kryesore të mëposhtme:

• *Liria nga dhuna me bazë gjinore – lufta kundër dhunës ndaj femrave, si*

dhuna fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike.

• *Standardet më të larta shëndetësore – siguri i kushteve të barabarta për kujdesin shëndetësor, duke përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues. Pagë e barabartë dhe fuqizim ekonomik – zvogëlimi i hendekut gjinor në paga dhe mundësi i mundësive të barabarta ekonomike.*

• *Ekulibri midis punës dhe jetës – mbështetje për kushtet fleksibile pune, duke përfshirë mungesat familjare dhe qasje në kujdes cilësor.*

• *Mundësi të barabarta për punësim dhe kushte të përshtatshme pune – lufta kundër diskriminimit gjinor në tregun e punës.*

• *Mundësi të barabarta punësimi dhe kushte të përshtatshme pune – luftimi i diskriminimit gjinor në tregun e punës.*

• *Arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës – promovimi i arsimit që do t'u mundësojë grave dhe vajzave të arrijnë qëllimet e tyre.*

- *Pjesëmarrja politike dhe përfaqësimi i barabartë – mbështetje për përfaqësim më të madh të grave në proceset politike.*

- *Mekanizmat institucionalë – që ofrojnë mekanizma për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave në të gjitha fushat.*

BE-ja është e përkushtuar për të avancuar të drejtat e femrave dhe barazinë gjinore në nivel global, duke përfshirë ndërhyrjet humanitare, dialogun politik dhe partneritetet me vende dhe organizata të tjera.

Përmbajtja e lajmeve:

Udhërrëfyes për forcimin e të drejtave të grave	1
Në fokus të Parlamentit Evropian	2-3
Tarifat doganore shtyhen	3
Aktivitetet parlamentare që lidhen me çështjet evropi-	4-5
Thirrje për investime private në Ballkanin Perëndimor	6
Digjitalizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Ballkanin Perëndimor	6
Propozim rregullativ për parandalimin e ndotjes me mikroplastika	7
Rregulla të reja për të forcurar sigurinë rugore	7
Direktiva mbi tatim minimal të korporatave të mëdha në BE	8
Aktivizimi i klauzolës nacionale për lëshim	8
Plan për forcimin e inteligjencës artificiale dhe pavarësisë teknologjike	9
Vende të sigurta për kthimin e emigrantëve	9
40 vjet Shengen	10
shënimi i ditës së Evropës	10
Rekord të rinj në platformat e rezervimeve online në vitin 2024	11
Kalendari i BE-së / Maj 2025	11

NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN



www.europarl.europa.eu

Seanca Plenare 31.3 - 3.4.2025

Në seancën plenare, eurodeputetët debatuan për tregtinë, mbrojtjen dhe konkurrencën, me kryetarin e Këshillit Evropian Antonio Costa dhe kryetaren e Komisionit Evropian Ursula fon der Lajen, duke insistuar në veprime për të forcuar ekonominë dhe mbrojtjen e BE-së. Kryetari A. Costa theksoi qartë "ndjenjën për urgjencë" së udhëheqësve për të forcuar konkurrencën e Evropës dhe krijimin e kushteve për më shumë investime në mbrojtje.

Eurodeputetët miratuan udhëzimet e Parlamentit për buxhetin e BE-së për vitin 2026 me 441 vota, duke theksuar se buxheti i vitit të ardhshëm duhet të fokusohet në përgatitjen dhe sigurinë strategjike, konkurrencën dhe rezistencën ekonomike, qëndrueshmërinë, klimën dhe tregun e vetëm. Në tekstin e miratuar, eurodeputetët bëjnë thirrje për përmirësimin e sigurisë, sigurisë kibernetike dhe aftësive mbrojtëse të BE-së, si dhe financim për infrastrukturën e transportit me përdorim të dyfishtë.

Parlamenti Evropian e miratoi raportin e tij vjetor mbi të drejtat e njeriut dhe demokracinë në botë për vitin 2024, duke paralajmëruar për përqësimin e situatës globale të të drejtave të njeriut.

Në raportin për Politikën e përbashkët të jashtme dhe sigurisë (PPJS), të miratuar me 378 vota, Parlamenti Evropian paralajmëron se lufta agresive e Rusisë kundër Ukrainës po gërryen arkitekturën e sigurisë së Evropës, duke destabilizuar dhe kërcënuar fqinjësinë e Evropës Lindore dhe Ballkanin Perëndimor.

Parlamenti Evropian ka mbështetur me 531 vota shtyrjen e datave të zbatimit të ligjeve të reja të BE-së për kërkesat e kujdesit të duhur për qëndrueshmërinë dhe raportimin. Eurodeputetët mbështetën propozimin e Komisionit, si pjesë e përpjekjeve më të gjera për thjeshtim që synojnë forcimin e konkurrencës së BE-së.

Zbatimi i direktivës për raportimin e qëndrueshmërisë do të vonohet për dy vjet për valën e dytë dhe të tretë të

kompanive të mbuluara nga legjislacioni. Kompanitë e mëdha me më shumë se 250 të punësuar do të duhet të raportojnë mbi masat e tyre sociale dhe ekologjike për herë të parë në vitin 2028 për vitin financiar të mëparshëm, ndërsa ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të listuara do të duhet ta paraqesin këto informacione një vit më vonë. Me 427 vota, eurodeputetët kërkuar përshejtimin e aktiviteteve për propozimin e "ndaloni kohën" për të shtyrë zbatimin e masave për kompanitë, për raportimin dhe analizat e thella për nivel social dhe ekologjik.

Me votim të fshehtë, eurodeputetët me 437 vota mbështetën emërimin e Luçijan Romashkanu si anëtar i Rumanisë në Gjykatën Evropiane të Revizorëve (GJER).

Eurodeputetët miratuan dy propozime për shpërndarjen e kredive Jordanit dhe Egjiptit me vlerë përkatëse prej 500 milionë euro dhe 4 miliardë euro. Ndiham Makro-Financiare (NMF) për Egjiptin u miratua me 452 vota, dhe NMF për Jordaninë u miratua me 571 vota.

Me 518 vota, eurodeputetët dhanë pëlqimi për marrëveshjen e përditësuar për peshkatari me Guinea-Bisau, e cila u jepet 41 anijeve të BE-së qasje në ujërat e vendit për pesë vitet e ardhshme. Në këmbim, BE-ja do të ofrojë 85 milionë euro financim gjatë pesë viteve. Kjo përbëhet nga 17 milionë euro në vit, ku 4.5 milionë euro veçohen në vit për të promovuar menaxhimin e qëndrueshëm me peshkatarinë në Gvineë-Bisau dhe për të mbështetur komunitetet lokale të peshkatarisë. Kjo është një rritje prej 1.4 milion eurosh në vit, krahasuar me marrëveshjen e mëparshme.

NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIANT

Në Rezolutën e miratuar, eurodeputetët kërkuar masa shtesë për të forcuar konkurrencën e industrive intenzive energjetike dhe për t'i ndihmuar ato në kalimin drejt proceseve të pastra industriale. Rezoluta thekson nevojën për një tranzitim fitimprurës me përdorimin e teknologjive të ndryshme për të ulur shpenzimet e energjisë dhe për të shmangur efektet e bllokimit. Parlamenti Evropian bëri thirrje për masa për të forcuar konkurrencën e industrive intezive të energjisë dhe për t'i ndihmuar ato të kalojnë në procese të pastra industriale.

Parlamenti Evropian miratoi rezoluta për të drejtat e njeriut për Kamerunin, Iranin dhe Bellorusinë.



TARIFA DOGANORE TË PROLONGUARA

Bashkimi Evropian miratoi vendim ti lë ë pushim kundër-tarifat kundër SHBA-së në kohë zgjatje për 90 ditë, me qëllim që të krijojë hapësirë për negociatë. Këto tarifa u vendosën si përgjigje të tarifave amerikane për çelikun dhe aluminin, të cilat u inponuan nga administrata e Presidentit Donald Trump. Plani fillestar i BE-së parashikonte vendosjen e tarifave për produktet amerikane me vlerë 21 miliardë euro (ndër të cilat: soja, bakri, motoçikletat, hekuri, barkat dhe lëngun e portokallit).

Sipas planit, grupi i parë i kundërmasave, me vlerë 3.9 miliardë euro, duhej të hynte në fuqi më 15 prill, por vendimi u shty.

Kryetarja e Komisionit Evropian, Ursula fon der Lajen, shpjegoi në deklaratë për mediat se pushimi i masave kundërmasave ka për qëllim të mundësojë negociatat dhe mundësinë për të gjetur zgjidhje me Uashingtonin.

Ky vendim vjen disa orë pasi Presidenti Donald Trump njoftoi se SHBA-të do të pezullonin "carinat reciproke" të reja për 90 ditë, për shkak të presionit në rritje nga tregjet.

BE-ja ende përballlet me shkallë doganore bazë prej 10% të disa produkteve, ndërsa çeliku, alumini dhe makinat mbeten të ngarkuara me tarifa prej 25%. Komisioni Evropian, i cili ka kompetencë për të përcaktuar politikën tregtare të Bashkimit, vazhdon të kërkojë zgjidhje. kryetarja e KE propozoi koncept dogana "zero-për-zero", përkatësisht heqjen e plotë të tarifave industriale midis BE-së dhe SHBA-së, i cili u refuzua si propozim i mjaftueshëm.

Sipas të dhënave për vitin 2023, BE-ja kishte suficit në tregtinë e mallrave me SHBA-në prej 156.6 miliardë euro, por njëkohësisht deficit tregtar prej 108.6 miliardë euro në sektorin e shërbimeve.

Vendimi i BE-së për të ndaluar luftën tregtare është përpjekje për të shmangur paqëndrueshmërinë e mëtejshme ekonomike, por rezultati i negociatave do të varet nga gatishmëria e të dyja palëve për të gjetur kompromis.



<https://www.euronews.com>

AKTIVITETE PARLAMENTARE TË LIDHURA ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Më 9 prill 2025 kryetari i Kuvendit, Afrim Gashi realizoi takim me kryetaren e Kuvendit të Sllovenisë, Urshka Klakoçar Zupançič. Në takim u konfirmua angazhimi dhe përkushtimi i ndërsjellë i të dyja palëve për të thelluar më tej bashkëpunimin midis dy shteteve, përfshirë edhe nivelin parlamentar. Në takim morën pjesë Vesna Bendevska, nënkryetare e Kuvendit, deputetët Musa Xhaferi, Lupço Nikollovski, Kaltrina Beqiri dhe Marina Dimovska, sekretare e përgjithshme e Kuvendit.

Takim me Urshka Klakoçar Zupançič realizuan edhe nënkryetari i Kuvendit dhe kryetar i Komisionit për Çështje Evropiane, Antonio Milloshoski dhe anëtarët e komisionit. Në takim, Milloshoski u ndal te pengesat me të cilat përballet vendi ynë në rrugën e gjatë drejtë realizimit të qëllimit të tij strategjik.

Në kuadër të vizitës zyrtare të Delegacionit nga Kuvendi Shtetëror i Republikës së Sllovenisë, u zhvillua takim midis Sekretareve të Përgjithshme të Kuvendit, Marina Dimovska, dhe Kuvendit Shtetëror, Urshulla Zore Tavçar.



www.sobranie.mk

Më 25 prill 2025, Kryetari Gashi realizoi takim me Ervin Ibrahimoviq, nënkryetar i Qeverisë së Malit të Zi për marrëdhënie ndërkombëtare dhe ministër i Punëve të Jashtme. Në takim morën pjesë edhe Sekretarja e Përgjithshme e Kuvendit, Marina Dimovska dhe deputetët Merita Kollçi Koxhaxhiku, Ilir Demiri dhe Oliver Spasovski. Në fokus të takimit ishte integrimi i të dy vendeve në BE. U theksua bashkëpunimi midis parlamenteve të të dy vendeve, si një nga faktorët kryesorë në procesin e integritimit të vendeve në BE.



Më 23 prill 2025, në Kuvend u mbajt Konferencë me temë: Rëndësia e Mbikëqyrjes Parlamentare në mbrojtjen dhe avancimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Në diskutim morën pjesë deputetë, përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore, organizatave joqeveritare, ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë, të cilët theksuan nevojën për "lidhshmërinë e politikës dhe praktikës dhe për të forcuar mbikëqyrjen parlamentare në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut". Kryetari i Kuvendit, Afrim Gashi, e theksoi mbikëqyrjen parlamentare si element të domosdoshëm në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke theksuar se është përgjegjësi e pushtetit legjislativ të mbrojtë të drejtat dhe zërin e qytetarëve.

AKTIVITETET E KUVENDIT TË LIDHURA ME ÇËSHTJET EVROPIANE

Për përfitimet e Agjendës Reformuese 2024-2027, në kontekstin e proceseve të eurointegritimeve të Maqedonisë së Veriut dhe Ballkanit Perëndimor, u diskutuan në debat në Kuvend, i cili u mbajt më 22 prill të këtij viti, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Komisionit për Çështje Evropiane dhe anëtarëve dhe përfaqësuesve të Këshillit Nacional për Eurointegritime. Në këtë aktivitet folën kryetari i Kuvendit, Afrim Gashi, nënkryetari i Kuvendit dhe kryetar i Komisionit për Çështje Evropiane, Antonio Milososki, kryetari i Këshillit Nacional për Eurointegritim, Venko Filipçe, ish-kryenegociatori për negociatat e pranimit të Kroacisë me BE dhe eksperti i UNOPS-it, Vlladimir Drobnjak, ministri për Çështje Evropiane, Orhan Murtezani, ambasadorja e Zvicrës, Veronik Ulman dhe zëvendës ambasadori i BE-së, Ben Nupnau.



Delegacioni nga Komiteti i Përzier Parlamentar - Republika e Maqedonisë së Veriut dhe BE-ja, i udhëhequr nga kryetarja Ivanka Vasilevska, më 24.04.2025. në Parlamentin Evropian në Strasburg, zhvilloi takime me eurodeputetët Karlo Resler, kryesues i KPP, nga pala evropiane; me Marion Vallsman, Sunçana Glavak, Antonio Tanger Korea, anëtarë; Matijash Nemec, zëvendësanëtar; Tomas Vajc, raportues i PE-së për vendin tonë dhe me Matej Tonin, raportues në hije për vendin tonë, në kuadër të grupit politik të PPE-së në Parlamentin Evropian. në takimet u konfirmua vazhdimësia e shkëlqyer e bashkëpunimit parlamentar dhe mbështetja e Parlamentit Evropian për procesin tonë të eurointegritimit. Në lidhje me Rezolutën e miratuar nga Parlamenti Evropian për vendin tonë,

në bazë të Raportit për progresin e Komisionit Evropian, u konkludua se Propozim- versioni i parë, ashtu si në vitet e kaluara, pasqyron situatën në mënyrë të balancuar.

Më 30 prill 2025, në Kuvend u mbajt seancë konstituive e Grupit Parlamentar Ndërpartiak për ndjekjen e zbatimit të detyrimeve nga

Procesi të Berlinit dhe Agjendës së Reformës së Planit të Rritjes. Iniciativa për këtë Grup u paraqit në tetor të vitit të kaluar dhe u pranua nga të gjitha partitë. Në konstituimin e sotëm, formalisht për kryetar të së njëjtës, u zgjodh unanimisht nënkryetari i Kuvendit, Antonijo Milloshoski, me propozim të koordinatorit të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Micevski.



Deputetët Bojan Stojanoski, kryetar i Komisionit për Çështje Ekonomike, Punë dhe Politikë Energjetike, dhe Dimitar Kovačevski, anëtar i Komisionit, më 24 prill 2025 morën pjesë në takim të Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë kushtuar disponueshmërisë së energjisë elektrike dhe integritimit të burimeve të energjisë së ripërthitëse, të organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, i cili u mbajt në Bruksel, në Parlamentin Evropian.

THIRRJE PËR INVESTIME PRIVATE NË BALLKANIN PERËNDIMOR



Bashkimi Evropian shpalli Thirrje për shprehjen e interesit për të mobilizuar investimet private në Ballkanin Perëndimor, me qëllim mbështetjen e zhvillimit ekonomik të rajonit dhe integrimin e tij në tregun e vetëm të BE-së.

Thirrja u njoftua në Samitin Adriatik 2025 në Mal të Zi, që do të thotë se kompanitë nga BE-ja, Zona Ekonomike Evropiane dhe Ballkani Perëndimor ftohen të paraqesin propozime për projekte investimi. Afati i fundit për aplikim është 21 maj 2025.

Komisioni Evropian do të shqyrtojë propozimet dhe do të kërkojë të mbështesë projektet më të përshtatshme me instrumentet e disponueshme politike, teknike ose financiare, me qëllim stimulimin e investimeve private në zhvillimin e infrastrukturës, diversifikimin ekonomik, tranzicionet e gjelbra dhe digjitale, si dhe integrimin në zinxhirin e vlerave të BE-së, me qëllim që të mundësohet krijimi i vendeve të reja të punës dhe të zvogëlohet hendeku ekonomik në përputhje me Planin e Rritjes së Ballkanit Perëndimor.

<https://enlargement.ec.europa.eu>

DIGITALIZIMI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NGA BALLKANI PERËNDIMOR



Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), me mbështetjen e BE-së, përgaditi program "Go Digital", me vlerë 377 milionë euro, i destinuar për digjitalizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Ballkanin Perëndimor me qëllim stimulimin e inovacioneve dhe rritjes në sektorin privat.

Programi do të ofrojë fonde përmes kredive, granteve dhe ndihmës teknike për investime në digjitalizim, automatizim dhe teknologji të gjelbra.

Siç është parashikuar, BERZH do të ofrojë kredi deri në 350 milionë euro për institucionet financiare partnere nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, të cilat më pas do të huazojnë mjete hua ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Bizneset do të kenë gjithashtu mundësinë të përfitojnë nga stimujt e granteve në

shumën prej 10% të shumës së kredisë, të financuara nga BE-ja. Në total, BE-ja do të ofrojë 27.6 milionë euro në grante dhe asistencë teknike për programin përmes Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF). Programi mbështetet në programin pilot të suksesshëm në Bosnjë dhe Hercegovinë, përmes të cilit u mbështetën me investime gati 200 kompani vendase.

Ky program synon të ndihmojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në rajon të rrisin ndërgjegjësimin digjital dhe qasje në financë. Këto ndërmarrje do të jenë në gjendje të aplikojnë për financim për një gamë të gjerë teknologjish dhe investimesh, nga miratimi i proceseve industriale të automatizuara dhe robotike deri te përdorimi i mjeteve komplekse dixhitale për vendimmarrje, mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Linja e kredisë do të jetë e disponueshme në më shumë se 10 institucione financiare rajonale - banka dhe kompani lizingu - partnerë të BERZH-it.

<https://www.eeas.europa.eu>

PROPOZIM-RREGULLORE PËR PARANDALIMIN E NDOTJES ME MIKROPLASTIKË

Përfaqësuesit e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së, më 9 prill 2025 arritën marrëveshje për tekstin e Propozim-rregullativë për parandalimin e ndotjes me mikroplastikë, e cila duhet të sigurojë mbrojtjen e mjedisit jetësor, por edhe t'i mundësojë industrisë evropiane të vazhdojë të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme.

Komisioni Evropian e mirëpriti marrëveshjen, duke theksuar se ajo do të bëjë të mundur uljen e humbjeve të plastikës gjatë proceseve të përditshme të punës ose gjatë transportit, të cilat përfundojnë në mjedis jetësor, përfshirë edhe në dete.

Rregullat e reja pritet të zvogëlojnë humbjet e lëndëve të para plastike deri në 74%, gjë që do të ndihmojë në ruajtjen e ekosistemeve dhe biodiversitetit, uljen e rreziqeve për shëndetin e njeriut dhe përmirësimin e reputacionit të sektorit. Nga ana tjetër, zgjidhjet e reja ligjore do të jenë të dobishme për aktorët ekonomikë në sektorë të shumtë, siç janë bujqësia, akuakultura dhe turizmi.

Sipas analizave, plastika ndot ujë dhe tokën, zonat bujqësore, dëmton ekosistemet dhe biodiversitetin, duke shkaktuar dëme fizike ose zhdukjen e speciet detare dhe bregdetare, siç janë breshkat e detit, zogjtë e detit dhe guacat.

Qëllimi i rregullativës është të zvogëlojë ndotjen nga plastika, të kufizojë përdorimin e produkteve me mikroplastikë të shtuar qëllimisht dhe të zvogëlojë çlirimin e paqëllimshëm të mikroplastikës në natyrë. Me Planin e Veprimit për Ndotje Zero, deri në vitin 2030, ndotja duhet të reduktohet me 30% krahasuar me nivelin aktual.

Marrëveshja e arritur duhet të miratohet nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i BE-së, të cilët do ta miratojnë zyrtarisht rregulloren e re.



<https://ec.europa.eu/commission>

RREGULLAT E REJA PËR TË PËRFORCUAR SIGURINË RRUGORE

Për të përmirësuar sigurinë rrugore dhe cilësinë e ajrit në të gjithë BE-në, Komisioni Evropian propozoi më 24 prill 2025 një rishikim gjithëpërfshirës të rregullave për sigurinë rrugore dhe regjistrimin e automjeteve të BE-së.

Rregullat e reja do të marrin në konsideratë praninë në rritje të automjeteve elektrike dhe do të përshtaten me teknologjitë e reja. Ata do të prezantojnë inspektime të përforcuara, duke përfshirë inspektime teknike periodike për automjetet elektrike dhe sistemet e avancuara të asistencës për shoferin, inspektime vjetore për makinat dhe furgonët e vjetër, si dhe metoda të përparura të testimit të emetimeve për të zbuluar automjetet me emetim të lartë për të zvogëluar ndotjen nga grimcat e imëta.

Përveç kësaj, Komisioni propozon të prezantojë certifikata për regjistrimin digjital të automjeteve dhe testimin periodik, për të thjeshtuar ndarjen ndërkufitare të të dhënave dhe për të mbrojtur qytetarët nga aktivitete mashtruese, të tilla si manipulimi i kilometrazhit. Inspektimet teknike periodike do të bëhen gjithashtu më të lehta për ata që banojnë përkohësisht në një vend tjetër të BE-së.

Ndryshimet e propozuara pasqyrojnë angazhimin e BE-së për lëvizshmëri të sigurt dhe të qëndrueshme, duke siguruar njëkohësisht lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave. Midis viteve 2026 dhe 2050, vlerësohet se këto propozime do të shpëtojnë rreth 7,000 jetë dhe do të parandalojnë rreth 65,000 lëndime të rënda. Për këtë qëllim, Komisioni propozon të rishikojë tre direktiva: mbi inspektimin teknik periodik (PTI) të automjeteve, dokumenteve të regjistrimit të automjeteve dhe mbi inspektimin rrugor (RSI) të automjeteve tregtare.



<https://transport.ec.europa.eu>

DIREKTIVA MINIMALE E TATIMIT PËR KORPORATAT E MËDHA NË BE



Tatimimi minimal i korporatave: vazhdimi me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacioneve midis shteteve anëtare. Këshilli i BE-së i forcon masat për tatimim dhe biznesin me miratimin e direktivës për bashkëpunim tatimor - e njohur zakonisht si DAC9 - për të vënë në fuqi marrëveshjen globale G20/OECD për dispozitat e reformës ndërkombëtare tatimore, të arritur më 2 korrik 2021.

Direktiva e propozuar mbi tatimim minimal të korporatave të mëdha - e cila do të vendoste një taksë prej të paktën 15% për çdo kompani me një xhiro vjetore mbi 750 milionë euro - lidhet me çështjen e tatimit digjital. Ndërsa taksimi minimal (Shtylla 2) është e BE-së, politika tatimore për operatorët e internetit (Shtylla 1) është pjesë e marrëveshjes me OECD-në dhe për këtë arsye i

nënshtrohet marrëveshjes ndërkombëtare. Marrëveshja e arritur më 14 prill të këtij viti në Këshillin e BE-së i referohet Shtyllës 2.

Mirëkuptimi i arritur midis ministrave të 27 shteteve anëtare zgjeron rregulloret e transparencës tatimore. Në mënyrë specifike, kjo thjeshton raportimin për kompanitë e mëdha duke mundësuar paraqitjen qendrore të një deklarate plotësuese tatimore (TTIR), pra një paraqitje të vetme të kompanisë për të gjithë grupin e prekur, në vend që të paraqitet në nivel lokal, pra veçmas për subjektet e korporatave. Gjithashtu, ai prezanton një model standard për paraqitjen e TTIR-ve në të gjithë BE-në, në përputhje me atë të zhvilluar nga Korniza Gjithëpërfshirëse e G20/OECD-së mbi Erozionin e Bazës dhe Zhvendosjen e Fitimit (BEPS).

Direktiva e re DAC9 do të hyjë në fuqi pas botimit në Gazetën Zyrtare të BE-së. Shtetet anëtare miratojnë dhe publikojnë, deri më 31.12.2025, ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të përbushur këtë Direktivë. Raportimi i parë i integruar i taksave është planifikuar për 30 qershor 2026.

<https://taxation-customs.ec.europa.eu>

AKTIVIZIMI I KLAUZOLËS NACIONALE PËR LËSHIM



Dymbëdhjetë shtete anëtare të BE-së kanë paraqitur kërkesë me shkrim Komisionit Evropian për të aktivizuar klauzolë nacionale për lëshimin në kuadër të Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes, si pjesë e paketës "Plani për Evropën/Gatishmëria për vitin 2030" të ReArm, të paraqitur në mars 2025. Këto janë Belgjika, Danimarka, Estonia, Finlanda, Gjermania, Greqia, Hungaria, Letonia, Polonia, Portugalia, Sllovakia dhe Sllovenia. Kërkesa shtesë pritet të paraqiten në një fazë të mëvonshme, pasi disa vende anëtare kanë shprehur interes për të përdorur këtë klauzolë.

Aktivizimi i klauzolës nacionale për lëshim u ofron shteteve anëtare hapësirë shtesë buxhetore për të rritur shpenzimet e mbrojtjes, duke mbetur brenda rregullave fiskale të BE-së, në pajtim me dokumentin

të publikuar nga Komisioni si pjesë e paketës "Plani për Evropën/Përgatitja për 2030".

Për të siguruar qëndrueshmëri fiskale në afat të mesëm, devijimi nga rruga e rekomanduar e shpenzimeve neto do të kufizohet në një maksimum prej 1.5% të PBB-së, shpenzime shtesë për mbrojtjen për çdo vit aktivizimi deri në vitin 2028.

Komisioni tani do të vlerësojë kërkesat e paraqitura nga vendet anëtare me qëllim që t'i paraqesë rekomandime Këshillit mbi aktivizimin e klauzolës nacionale të lëshimit si pjesë e paketës së ardhshme të Semestrit Evropian për pranverën e vitit 2025. Këshilli do të ketë më pas një muaj për të vendosur për këtë çështje.

<https://ec.europa.eu>

PLAN PËR FORCIMIN E INTELIGJENCËN ARTIFICIALE DHE PAVARËSINË TEKNOLOGJIKE

Komisioni Evropian më 9 prill 2025 prezantoi "Plan Veprimi për një kontinent me inteligjencë artificiale", me qëllim përshpejtimin e përdorimit të inteligjencës artificiale (IA) në kompani dhe zvogëlimin e varësisë së Bashkimit nga rajone të tjera, veçanërisht në teknologjitë kritike si çipat dhe sistemet kuantike.

Kryetarja e Komisionit Ursula fon der Lajen në shkurt të këtij viti e njoftoi planin në Paris, duke e quajtur atë "mënyrë për të transformuar industrinë tradicionale në 'motorë të fuqishëm të inovacionit'".

Komisionerja Evropiane për Teknologjinë, Hena Virkunen, theksoi se është e nevojshme që BE-ja të ndërtojë kapacitetet e veta në sektorë të tillë si çipat e inteligjencës artificiale, përveç partneriteteve ekzistuese me SHBA. Unioni punon për një Akt të ri për Çipat 2.0, për të rritur pavarësinë e prodhimit.

Komisioni njoftoi se kompanitë mund të japin reagime deri në qershor të këtij viti, nëpërmjet një konsultimi publik mbi Ligjin për Zhvillimin e Inteligjencës Artificiale dhe Reve dhe Strategjinë "Zbatoni Inteligjencën Artificiale".

Në janar të këtij viti, Komisioni njoftoi se do të investonte rreth 20 miliardë euro në krijimin e gigafabrikave me rreth 100,000 çipa të inteligjencës artificiale të gjeneratës së fundit, që është katër herë më shumë se kapaciteti që po ngrihet aktualisht. Fabrika e parë e tillë mund të fillojë operacionet në vitin 2026.

BE-ja ka miratuar një Ligj për Inteligjencën Artificiale, i cili do të zbatohet gradualisht dhe do të jetë plotësisht në fuqi në vitin 2027. Qëllimi është që 75% e kompanive evropiane të përdorin inteligjencën artificiale deri në vitin 2030.

Megjithatë, Komisioni paralajmëron se Evropa po mbetet prapa SHBA-së kur bëhet fjalë për investimet dhe inovacionin në këtë sektor. Midis viteve 2008 dhe 2021, në Evropë u themeluan 147 startup-e, kompani me vlerë më shumë se një miliard dollarë, 40 prej të cilave zhvendosën selitë e tyre jashtë vendit, kryesisht në SHBA - arsyeja e përmendur ishte rregullimi i tepërt dhe barrierat administrative.

<https://ec.europa.eu>

VENDE TË SIGURTA PËR KTHIMIN E MIGRANTËVE

Komisioni Evropian planifikon të caktojë shtatë "vende të sigurta të prejardhjes" nga të cilat kërkesat për azil mund të përshpejtohen dhe potencialisht të refuzohen.

Lista përfshin Bangladeshin, Kolumbinë, Egjiptin, Indinë, Kosovën, Marokun dhe Tunizinë.

Azilkërkuesit që mbërrijnë në BE nga këto shtatë vende do të informohen se kërkesat e tyre janë refuzuar dhe do t'u dorëzohet një urdhër kthimi sipas rregullave të reja të BE-së.

Ky veprim pritet të pasohet nga një rishikim i përshpejtuar i konceptit të vendit të tretë të sigurt në ligjin e BE-së.

Koncepti i një vendi të tretë të sigurt u lejon azilkërkuesve të dërgohen në një vend ku mund të gjejnë mbrojtje, në vend që të qëndrojnë në vendin ku kanë aplikuar.

Lista do të përfshihet si amendament i rregullativës për procedurën e azilit të BE-së, pjesë e paktit të migracionit të miratuar vitin e kaluar. Duhet të zbatohet në vitin 2026.

Në mars të këtij viti, Komisioni propozoi rregulla të reja detyruese për kthimin e migrantëve, të cilat vendet e BE-së dhe eurodeputetët po i debatojnë tani.



<https://www.euractiv.com>

40 VJET SHENGEN



Komisioni Evropian publikoi raportin e katërt mbi gjendjen e Shengenit më 23 prill 2025, duke shënuar 40-vjetorin e tij. Raporti mbulon zhvillimet e vitit të kaluar dhe përcakton prioritetet për vitin e ardhshëm. Vitin e kaluar, zona Shengen ishte përsëri destinacioni më i vizituar në botë, me mbi gjysmë miliardi vizitorë dhe duke nxitur rritjen ekonomike në të gjithë Unionin.

Shengeni ka evoluar në një "sistem të fuqishëm dhe gjithëpërfshirës" në të cilin vendet- anëtare, me mbështetjen e Unionit, "menaxhojnë në mënyrë efektive kufijtë e jashtëm, sigurinë dhe migracionin në një mënyrë të koordinuar".

Anëtarësimi i plotë i Bullgarisë dhe Rumanisë në zonën Shengen forcon ndjeshëm ekonominë e BE-së "është provë se vendet- anëtare janë plotësisht të përkushtuara për përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit brenda zonës Shengen", theksoi Komisioni Evropian.

Kërkesat e Shengenit janë bërë një aspekt kyç i procesit të zgjerimit të BE-së, pasi të gjitha vendet kandidate duhet të kenë sisteme kombëtare të menaxhimit të Shengenit plotësisht funksionale në kohën kur pranohen në BE.

Përprjekjet e intensifikuara të BE-së kanë çuar në një ulje të kalimeve të parregullta në kufijtë e jashtëm të Shengenit, me rreth 240,000 raste - më e ulëta që nga viti 2021. Nevojiten përpjekje më të mëdha për të rritur bashkëpunimin politik dhe shkëmbimin e informacionit për të menaxhuar Marrëveshjen, për të përsheptuar dixhitalizimin, për t'u përshtatur me sfidat e reja të sigurisë dhe për të zbatuar riatdhesimet për hyrjet e paligjshme.

<https://home-affairs.ec.europa.eu>

SHËNIMI I DITËS SË EVROPËS



Më 9 maj, Evropianët festojnë Ditën e Evropës. Ky vit 2025 shënon 75-vjetorin e Deklaratës së Shumanovës, e cila hodhi themelet e BE-së dhe hapi rrugën për një epokë të paparë prosperiteti, paqeje, demokracie, solidariteti dhe bashkëpunimi në Evropë.

Për të shënuar këtë rast, do të mbahen shumë aktivitete në vendet- anëtare të BE-së dhe në mbarë botën, duke bashkuar qytetarë nga të gjitha sferat e jetës. Institucionet e BE-së do të hapin dyert e tyre dhe do t'i ftojnë qytetarët të vizitojnë ambientet e tyre, të zbulojnë punën e tyre dhe të angazhohen në një gamë të gjerë aktiviteteve edukative dhe argëtuese.

Ndërtesa dhe monumente të rëndësishme në të

gjithë botën do të ndriçohen me ngjyrat e BE-së, ndërsa një program i veçantë për Ditën e Evropës është planifikuar për Ekspozitën 2025 në Osaka të Japonisë.

Në kohë pasigurie globale, Evropa mbetet një spirancë stabiliteti - një vend mundësish dhe mbrojtjeje për qytetarët e saj. BE-ja dhe institucionet e saj punojnë drejt qëllimit të përbashkët për të siguruar prosperitet dhe konkurrueshmëri, duke garantuar sigurinë dhe mbrojtjen tonë, duke respektuar njëkohësisht vlerat themelore për të cilat kujdesen evropianët.

<https://european-union.europa.eu>

REKORDET E REJA NË INTERNET PLATFORMAT E REZERVIMEVE NË VITIN 2024


Në vitin 2024, vizitorët kaluan 854.1 milionë netë në akomodime me hua afatshkurtër në BE, të rezervuara përmes Airbnb, Booking, Expedia Group ose TripAdvisor. Kjo përfaqëson rritje prej 18.8% krahasuar me vitin 2023 (719.0 milionë qëndrime me netë), që është një rekord i ri.

Me përjashtim të prillit, çdo muaj në vitin 2024 regjistroi një numër më të lartë qëndrimesh me netë në akomodime afatshkurtra krahasuar me të njëjtin muaj në vitin 2023. Rritjet më të mëdha krahasuar me vitin 2023 u regjistruan në mars (+48.0%), maj (+31.7%), gusht (+21.6%) dhe nëntor (+21.5%).

Informacioni vjen nga të dhënat mujore mbi akomodimin afatshkurtër të ofruar përmes platformave online. Eurostat publikoi të dhënat për tremujorin e katërt në nivel kombëtar dhe tremujorin e tretë në nivel rajonal.

Destinacioni më i mirë në verën e vitit 2024 është Kroacia Adriatike. Rajonet më të njohura për akomodime me hua afatshkurtra të rezervuara nëpërmjet platformave online në tremujorin e tretë të vitit 2024 ishin Kroacia Adriatike (25.2 milionë netë, +6.0% krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2023), Andaluzia në Spanjë (17.2 milionë netë, +23.1%) dhe Provence-Alpes Azuren Breg në Francë (15.6 milionë netë, +26.2%). Në të njëjtin tremujor, midis 20 rajoneve kryesore, gjashtë ishin në Francë, pesë në Spanjë dhe Itali, dy në Greqi dhe nga një rajon në Kroaci dhe Portugali.

<https://ec.europa.eu/eurostat>



KALENDARI I BE-së / Maj 2025

1. Takim Joformal i Ministrave të Jashtëm, 7-8/5/2025, Varshavë, Poloni;
2. Mbledhja e Këshillit të Punëve të Jashtme, 15, 20 dhe 25/5/2025, Bruksel;
3. Mbledhja e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme, 27/5/2025, Bruksel;
4. Seanca plenare e Parlamentit Evropian, nga 5-8 dhe 21-22/05/2025, Strasburg.

European Union Newsroom
europa.eu

Home Highlights Press releases **Calendar** Audiovisual Press contacts Press facilities Subscription services About the EU

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic
Choose a topic

By organiser
Choose an organiser

By type
Choose a type

BY MONTH

Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat	Sun
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						

Lidhje të dobishme për publikimet elektronike të BE-së:

<https://publications.europa.eu/en/home>

<https://europa.eu/european-union/documents-publications>

<http://www.europarl.europa.eu/visiting/en/brussels/parlamentarium>



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

QENDRA BE E KUVENDIT

Adresa: „11 Tetori“ numër 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 55 lokale 414 dhe 277

E-posta: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

www.sobranie.mk

Në Kuvend u zbatua projekt IPA për "Ndihmë Teknike për Parlamentin" në periudhën nga janari 2011 deri në qershor 2012, objektivi i përgjithshëm i të cilit ishte forcimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe në këtë mënyrë përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së tij ndaj qytetarëve.

Në kuadër të projektit IPA, u ofrua ndihmë financiare dhe nga ekspertë për krijimin e një Qendre të BE-së në Kuvend.

Qëllimi i krijimit të Qendrës së BE-së është t'u ofrojë deputetëve në Kuvend dhe Shërbimit të ju sigurohet akses më të mirë në informacione që lidhet me çështjet e BE-së.

Qendra e BE-së është organizativisht brenda Sektorit për Mbështetjen e Këshillit Nacional për Integrimin Evropian dhe Monitorimin e Integritimit Evropian.

Qendra e BE-së posedon bibliotekë me libra dhe botime nga fusha të ndryshme të politikave evropiane.

